

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**


Konkursi

Mbro privatësinë tënde gjatë lundrimit në internet

28 Janar 2016
Dita e Mbrojtjes së
të Dhënave Personale

www.idp.al





KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Mbro privatësinë tënde gjatë lundrimit në internet

28 Janar 2016

Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Aktiviteti u mundësua nga



**Raiffeisen
BANK**

Fitoni çdo sfidë

Titulli:

Konkursi “Mbrotivatinë tëndë gjatë lundrimit në internet”
28 Janar, 2016

Përgatitur nga:

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e
të Dhënave Personale

Mundësuar nga:

Raiffeisen Bank

Me bashkëpunimin e:

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Botuar nga:

APA-Albpartners

Mars, 2016



Jimena Qarri
Shkolla "Sevasti Qiriazhi" Korçë



Pamela Hajdëraj
Shkolla "Jeronim de Rada" Tiranë



Melisa Mali
Shkolla “Kushtrimi i Lirisë” Durrës



Sara Sali
Shkolla “Papa Kristo Negovani” Ersekë



Iva Kristo
Shkolla "Sevasti Qiriazi" Korçë



Ana Zhula, Tea Irakli
Shkolla "Sevasti Qiriazi" Korçë



Ilia Misho, Kristi Simaku
Shkolla “Sevasti Qiriazhi” Korçë



Mikel Kamenica, Elona Kapedani
Shkolla “Sevasti Qiriazhi” Korçë

Megan Vila
Shkolla "Sevasti Qiriazi" Korçë



Vangjush P., Andrea Cicko
Shkolla "Sevasti Qiriazi" Korçë




Elsa Gjeçaj
Shkolla “Ali Podrimja” Bajram Curri



Uesli Shtufi
Shkolla “Jeronim de Rada” Tiranë

Sara Rroshi
Shkolla “3 Dëshmorët” Kavajë



Nesila Bylyku
Shkolla “Jeronim de Rada” Tiranë



Nelsi Ajazi
Shkolla “Besëlidhja” Lezhë



Estela Murataj
Shkolla “Jeronim de Rada” Tiranë



Eriselda Mustafaj, Elsa Gjoçaj
Shkolla "Ali Podrimja" Bajram Curri



Leart Lika
Shkolla "Ndre Mjeda" Shkodër



Selma Gjoni
Shkolla "Fiqiri Kurti" Kavajë



Noele Ajazi
Shkolla "Besëlidhja" Lezhë



Ana Prifti
Shkolla “Naim Frashëri” Fier



Eden Fetahu
Shkolla “Jeronim de Rada” Tiranë




Fabiola Ahmetaj
Shkolla “Jeronim de Rada” Tiranë



Endri Gegolli
Shkolla “17 Shkurti” Qesarakë, Tiranë



Xhesilda Paja
Shkolla "17 Shkurti" Qesarakë, Tiranë



Xhoma Pano
Shkolla "Jeronim de Rada" Tiranë



Megi Minxolli
Shkolla "17 shkurti" Qesarakë, Tiranë



Kejdi Çuni
Shkolla "17 Shkurti" Qesarakë, Tiranë



Rezarta Kasëmi
Shkolla "Naim Frashëri" Fier



Suela Mesia
Shkolla "Sali Gjuka" Ura Vajgurore



Klen Cuni
Shkolla "Mustafa Gjestila" Mat



Irda Pateriku, Eneida Barbullushi
Shkolla "Ndre Mjeda" Shkodër



Kejsi Bako
Shkolla "Jeronim de Rada" Tiranë



Olvi Xhaferraj
Shkolla "Jeronim de Rada" Tiranë



POEZI DHE ESE

INTERNETI!

Ç'është kjo bota e internetit,
dikush duhet të na mësojë,
ç'dëme sjell tek ne të vegjlit,
pse s'na lënë që të lundrojmë?

Kur na qenka e ndaluar,
pse çdo shtëpi kompjuter ka,
pse tablet mbajnë në duar,
pse gjithmonë rrimë online?

Interneti nuk është i gabuar,
por edhe të këqija ka,
është një botë shumë e trazuar,
se kuptojmë, duhet të rritemi edhe ca.

Punoi: Kledi Saliko
Shkolla "Naim Frashëri" Fier
III A

NJERIU DHE VJEDHJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Ndërsa teknologjia vazhdon galopimin e pandalshëm drejt zenitit “të papushtuar” nga askush, “qenie një-rëzore”, LIBRI pesëmijëvjeçar, ndoshta, përkohësisht, i ka hapur rrugën asaj. I lodhur nga ky duel rraskapitës, pasi kjo teknologjia e ndau nga lexuesi i saj besnik, në një farë mënyre, ia ndau trupin nga shpirti. Teknologjia “ia vodhi” shpirtin librit, duke ia lënë vetëm trupin e pluhurosor nga shekujt. Por, akoma më keq sesa LIBRI e pësoi NJERIU, viktima e radhës së teknologjisë. Njeriu i lodhur nga puna e rëndë dhe më kryesorja, nga mungesa e komunikimit global për pak “çlodhje” u gëzua, u entuziazmua dhe kaloi në delir, kur lindi kjo “foshnjë” e çuditshme, e mistershme, që as në ëndrrat më donkishoteske se kishte imagjinuar se do të bëhej realitet. Vazhduan lindjet natyrale të njëpasnjëshme nga interneti: Facebook, Tëitter, Skype, Viber, Instagram... O Zot! Sa emra të tmerrshëm dhe mistikë iu dukën në fillim NJERIUT! Por, dalëngadalë u afrua duke e ledhatuar dhe ajo, tërheqëse si vdekja, e bëri për vete. Tani është engjëlli me të cilin ha bukë, fle, shkon në punë...bashkudhëtari i pandashëm, duke e lënë ditë e natë pa gjumë, duke e lodhur, vjedhur, vyshkur... Por, “muajt e mjaltit” nuk zgjatën dhe aq shumë.

Ai, NJERIU i padjallëzuar iu dorëzua tërësisht në besë Facebook-ut dhe pjellave të saj, duke iu hapur zemrën, duke ia rrëfyer të gjitha të fshehtat e zemrës, që ndoshta nuk do kishte guxuar t’ia thoshte dhe vetvetes. Fotot në kënde të ndryshme, bisedat në momentet më intime,

siç theksova edhe më lart, njeriu ia dorëzoi “shpirtin” teknologjisë që të kyçeshin për jetë aty si Sant Gral i famshëm. Kështu, NJERIU ra viktimë duke e zhveshur, i morën shpirtin, duke i lënë të pavlefshëm vetëm trupin e akullt. Rrufeja ra mbi njeriun kur pa në faqet e rrjeteve sociale fotot, bisedat, momentet e tij më intime që ia kishin vjedhur, ia kishin vjedhur shpirtin. Kështu, njeriu është i vdekur, sepse i ka vdekur shpirti. Shpirtin e tij e kanë në dorë të pashpirtët. Njësoj ndodh edhe me insektin e bekuar nga Zotin, që kur e ngacmojnë ikën duke e lënë aty zgjojin e boshatisur dhe të pajetë. Kërkon të jetë si më parë NJERIU, por nuk kthehet dot në kohë, koha është larguar me vite-dritë larg. Tashmë, asgjë nuk është në dorën e njeriut, si një mizë në karrocën e tërhequr nga kuajt e harbuar... Lamtumirë O NJERI HERMETIK!!

Ti, tani mund të gjendesh vetëm në ndonjë planet mijëra vite-dritë larg nesh, ku kjo teknologji ka “përtuar të ndalojë”...

Punoi: Jonida Morina
Shkolla “Avni Rustemi” IX-c Kukës

MBRO PRIVATËSINË!

Mbrojtje nënkupton siguri e siguri do të thotë mungesë kanosje e mungesë rreziku. Mbro privatësinë nënkupton të jemi të sigurt brenda kufizimeve të asaj që ne e emërtojmë personale, vetjake, larg syrit të të panjohurve, a të të bezdisurve .

Mbro privatësinë teksa lundron në internet, këtu mbrojtja dhe privatësia duket sikur humbin nga thelbi i tyre e iu cënohet domethënia .

Internet, rrjetet kompjuterik global që siguron larmishmëri informacioni e lehtësi komunikimi në rrjete të ndërlidhura e me protokolle të standartizuara. Si t'i lidhim këto hallka bashkë për të bërë një zinxhir të qëndrueshëm? Ne duhet t'i lidhim pasi treguesit janë domethënës:

-32% e adoleshentëve janë viktimë e bullizmit apo ngacmimeve në rrjet;

-15% e adoleshentëve kanë patur publikim të bisedave private në rrjet;

-13% e adoleshentëve kanë gjetur thashetheme të përhapura për ta në rrjet;

-13% e adoleshentëve kanë marrë mesazhe abuzive gjatë përdorimit të rrjeti.

Çfarë duhet bërë për të qenë njëkohësisht të lirë e të mbrojtur? Unë mendoj se duhet të duam shumë veten, pa kushte, e mbi gjithçka e përkthyer ndryshe, në kujdes maksimal për veten, si gjënë më të shtrenjtë që kemi. Le ta thjeshtojmë në argument.

Së pari, të mos vizitojmë faqe që nuk janë për moshën tone. Kjo tingëllon paksa ironike e predikuese, kur jemi në moshën e kuriozitetit maksimal e të pikëpyetjeve të mëdha, ama, vlen të nënvizohet që pikëpyetjet e sotme mbajnë përgjigjet që do formojnë personalitetin tonë nesër. Mendimi im është që këto përgjigje t'i marrim

nga prindërit, mësuesit apo nga psikologët. Kjo trini duhet të ketë rol e bashkëpunim të fuqishëm në këtë aspekt.

Së dyti, personalja është personale, gjithmonë. Nuk duhet të harrojmë se çdo gjë që publikohet mbetet aty e nuk ka më kthim pas. Kodet duhet t'i trajtojmë si furçat e dhëmbëve, personale dhe të ndërrohen maksimumi çdo gjashtë muaj.

Së treti, prindërit kur ishim të vegjël na porosisnin që të shikojmë në të dy anët para se të kalojmë rrugën, si dhe të mos hipim në makinë me të panjohur. Kjo vlen edhe për rrjetet sociale, kur duam të publikojmë apo të ndajmë informacion. Le të analizojmë fillimisht, a është e nevojshme, a është frymëzuese, a përfitojmë diçka, si dhe a është e këndshme dhe etike ajo që ne po bëjmë publike?

E fundit, e jo më pak e rëndësishme, cyberbulling – ngacmimi në rrjet, një nga format më të egra dhe më të vështira për t'u kontrolluar. Liria e secilit prej nesh përfundon aty ku nis e tjetrit. Rolet janë lehtësisht të ndërrueshme, ndaj kurrsesi të mos jemi sulmues dhe gjithmonë, të flasim pa frikë kur ndihemi të kërcënuar. Duket sikur të thëna bukur e të rradhitura njëra pas tjetrës, gjërat janë të thjeshta. Unë e di që nuk është kështu, e di që duhet punë, pasi kur hyjmë në rrjet ne i harrojmë gjysmat e këshilave rrugës. Duhet që më të ndërjegjeshmit t'i kujtojnë herë pas here shokët e tyre më pak të vëndshëm, që në fund të përfitojmë ne nga rrjeti e jo rrjeti prej nesh, pa na viktimizuar!

Punoi: Detjona Avllaj

KI IX-C

MBRONI PRIVATËSINË TUAJ GJATË LUNDRIMIT NË INTERNET

-Sot është një ditë e madhe për të gjithë ne, pasi sot ne do të bëjmë atë që shumë para nesh janë munduar ta kryejnë, por vetëm pak janë kthyer dhe ata pak që janë kthyer, nuk janë të aftë të tregojnë. Por ne nuk jemi si ata. Ne do arrijmë të kthehemi e do të tregojmë historinë. A jeni gati?

-Po, zotëri! Pas urdhrimit tuaj.

-Ekuipazhi! Bëhu gati për lundrim! Ngrini spirancën! Lëshoni velat! Drejtoni timonin 5 gradë majtas dhe 2 gradë në veri! Na priftë e mbara. Le të nisemi!

Dy orë pas nisjes një anëtar i ekuipazhit i afrohet kapitenit që është në timon.

-Zotëri?

-Po, fol.

-Kemi gjetur një anije, zotëri. Kërkojmë leje të shkojmë të kontrollojmë.

-Çfarë? Anije? Le të shkojmë.

Anija ishte gati e shkatërruar e përmbysur në njerin krah, duke pritur fatin e saj, priste që dallgët që e godisnin pa mëshirë të hapnin gojën e ta gllabëronin. Kapiteni së bashku me dy pjesëtarë të ekuipazhit, shkuan të kontrollin këtë anije. U ngjitën nëpërmjet kicët të anijes, ose më saktë, asaj çfarë kishte mbetur prej saj. Kishte vetëm dërrasa të thyera dhe ujë që po futej gjith-

monë e më shumë e që kishte një oshëtimë djallëzore, sikur të thoshte “nuk shpëton dot më”. Ishte shumë e rrezikshme të qëndronim aty, por kur sapo largoheshin dëgjuan një zë që po thërriste për ndihmë e më vonë, u pasua nga disa të tjerë. Poshtë disa dërrasave panë diçka. Nuk ishte diçka, ishte dikush. Disa fëmijë të lidhur që qanin e kërkonin ndihmë. Anija filloi të lëkundej dhe uji tani e kishte rritur shpejtësinë. Zgjidhën shpejt fëmijët, i morrën në krahë dhe shkuan në anijen e tyre. Fëmijët ishin të trembur, ndaj në fillim i lanë të çlodheshin e pastaj, mund t’i pyesnin se çfarë kishte ndodhur. Pak më vonë, njëri nga fëmijët mundi të fliste. Ai nuk i la fare ta pyesnin por filloi të tregonte vetë.

-Jam 14 vjeç. U nisa në këtë anije me disa shokë për të zbuluar skutat e errëta të oqeanit Internet. E menduam një udhëtim të lehtë, pa rreziqe, madje, disa prej nesh nuk morën lejen në mund të niseshim apo jo. Këtë udhëtim e morëm si lojë, por nuk e dinim se çfarë na priste. Mendonim se ishim të sigurt. Kishim vendosur fjalëkalimet tona, që ne mendonim se s’i gjente askush. Besoj, keni dëgjuar për Odiseun me sirenat. Kjo na ndodhi edhe ne. Deti ishte i qetë, kur papritur dallgë të mëdha u shfaqën dhe filluan të na godisnin, ishte një sulm virusesh, por që ne na dukej i ëmbël. Ata të ndillnin të shkoje drejt tyre, por ti nuk e dije që

shkoje drejt shkëmbinjve dhe thjesht i ndiqje. Fatmirësisht, njeri nga ekuipazhi që ishte shurdhuar nga kufjet që mbante në vesh, arriti të na shpëtonte. Menduam se pas kësaj s'do të kishte më rrezik, por jo. Na sulmuan piratët. Ishin të pamëshirshëm, merrnin gjithçka tënden, edhe atë që ti kishe menduar se e fshije më mirë, dhe largoheshin pa lënë gjurmë! Donim të ktheheshim por e kishim të pamundur. Për javë me rradhë jemi endur nëpër det për të gjetur një rrugë kthimi, por më kot. Më vonë, një stuhi detare e zuri anijen tonë dhe e shkatëroi, fatmirësisht erdhët ju... Më falni që ju pyes, por për ku jeni nisur?

-Kemi të njëjtin mision, të zbulojmë skutat e errëta të Internetit.

-Ja dhe përgjigja që i trembesha. Do niseni dhe pas kësaj që dëgjuat? Shikoni, nuk është trim vetëm ai që lufton deri në fund, por edhe ai që di se kur duhet të tërhiqet.

Kapiteni kthehet nga ekuipazhi.

-Dëgjoni ekuipazhi! Oqeani i Internetit është i rrezikshëm dhe ne u nisem të papërgatitur për këto rreziqe. A jeni të përgatitur të përballeni me viruset?

Heshtje.

-Po të luftoni me piratët?

Përsëri heshtje.

-Ashtu siç e prisja. Si kapiteni juaj, po ju them, se kjo anije do të kthehet e sigurt në port dhe ju premtoj ketu

sot, ku dëshmitar është vetë deti, se në ditën kur ju do të jeni gati dhe të aftë të luftoni kundër detit, unë do të jem krah jush dhe ne do ta bëjmë armikun Internet, mikun tonë. Por deri atëherë, në kërkim të një miku të ri, nuk dua të humbas miqtë e vjetër.

Ekuipazhi! Ngrini spirancën! Hapni velat! Drejtoni timonin për në shtëpi!

Punoi: Kristjan Qoku
Shkolla "Papa Kristo Negovani"
Ersekë





The background features several light blue, curved lines that sweep across the page, creating a sense of movement and framing the central text.

28 Janar 2016

Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale



Mbro privatësinë tënde gjatë lundrimit në internet

28 Janar 2016

Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale



Kontakt:

www.idp.al

info@idp.al

+355 42237200

08002050

**Rr. e Kavajës, Nd. 80,
H. 1, K. 5, Tiranë**